REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE FINANCËS

Nr 3404 prot. Gramsh, më 30/10/2026

RELACION
"Për dhënien e ndihmës financiare z. Alush Miraka

Mbështetur në Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar, në ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar , ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe kërkesës me nr.3404 prot. datë 21.08.2026 të paraqitur nga **z. Alush Miraka** banues në Njësinë Administrative Tunjë .

Shtetasi sipas kërkesës së tij shprehet se prej vitesh vuan nga tumori , ka bërë trajtim mjekësor me kimio terapi por është në vështirësi financiare për vazhdimin e kurimit të tij .

Bashkia Gramsh me kërkesën e bërë nga **z. Alush Miraka** , ku shprehet se paraqitet në gjendje të vështirë ekonomike, dhe nuk ka mundësi për përballimin e shpenzimeve për vazhdimin e kurimit të tij, mendon t'i vijë në ndihmë e t'i ofrojë një mbështetje financiare prej **50.000** (pesëdhjetë mijë) lekë për ti lehtësuar sado pak pamundësinë financiare dhe vështirësinë në të cilën ndodhet.

Bashkangjitur gjeni dokumentacionin i cili vërteton atë ç'ka përmendëm më sipër.

1 - Kërkesa
2 - Fotokopje e kartës së identitetit
3 - Epikriza mjekësore e plotësuar nga komisioni mjeko - ligjor

KRYETARE
Besion AJAZI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA GRAMSH